



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

Seanca Plenare

Seanca nr.2003/29

Prishtinë, më 23 tetor 2003, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit Komunal të Prishtinës.

PROCESVERBAL

Seancën e kryesoi Nexhat **DACI**, kryetar i Kuvendit, kurse bashkëkryesues ishte Bajram Kosumi, anëtar i Kryesisë.

Kryetari konstatoi se në seancë ishin të pranishëm 82 deputetë dhe e deklaroi të hapur punën e saj.

Rendi i ditës, i kësaj seance ishte propozuar, si vijon:

1. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme;
2. Shqyrtimi i dytë i P/ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësit-nr.2003/25;
3. Shqyrtimi i parë i P/ligjit për kadastër-nr.2003/30;
4. Shqyrtimi i parë i P/ligjit për barazi gjinore-nr.2003/29 dhe
5. Propozimi i rendit të ditës për seancën e ardhshme plenare, të datës 30 tetor 2003.

Kryetari bëri një prononcim lidhur me ndalimin dhe arrestimin e djeshëm të komandantit të TMK-së, gjenerallejtënant Agim Çeku, nga organet e rendit të Sllovenisë.

Me një fletarrest të një gjykatë inikzistente dhe të një pushteti inikzistent në Kosovë, dje u arrestua prijësi i njërit prej institucioneve më të rëndësishme të Kosovës. Kjo është hera e dytë që prijësit e Kosovës të poshtërohen, dinjiteti i tyre individual, por edhe Kosova, e kaluara, e tashmja dhe e ardhmja e saj.

Ai falënderoi përfaqësuesit e Bashkësisë Ndërkombëtare, veçanërisht z. Holker, që u angazhuan për lirimin e gjenerallejtënant Agim Çekut.

Ai theksoi se ka kërkuar nga UNMIK-u, që prijësit e institucioneve të Kosovës të pajisen me dokumente diplomatike të udhëtimit për mbrojtjen e dinjitetit dhe të identitetit të tyre, por deri më tani nuk është gjetur ndonjë zgjidhje.

Bujar Dugolli, theksoi se çështja e arrestimit të gjenerallejtënant Agim Çekut, nuk duhet të kalojë vetëm me një deklaram verbal.

Ai kërkoi që në seancën e sotme, çështja e arrestimit të gjenerallejtënant Çekut, të futet si çështje e ngutshme dhe Kuvendi i Kosovës të reagojë zyrtarisht me një deklaratë dhe të ngarkohet Qeveria e Kosovës t'ia bëjë një notë proteste Qeverisë së Sllovenisë.

Ai kërkoi që në një rën nga seancat e ardhshme të ftohet z. Holkeri dhe të shpjegoj se çka është duke bërë për mbrojtjen e dinjitetit të qytetarëve të Kosovës.

Berat Luzha, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, propozoi që Kuvendi të miratojë një deklaratë me të cilën në formë zyrtare protestohet ndaj veprimit të organeve shtetërore të Sllovenisë lidhur me arrestimin e gjenerallejtënant Agim Çekut.

Ai kërkoi që z. Holker të ndërmerrë masa të ashpra për pengimin e veprimit të institucioneve paralele të Serbisë në Kosovë.

Randjel Nojkiq theksoi se distancohet nga diskutimi i kryetarit të Kuvendit, ngase sipas tij ,ai paraqet vetëm shumicën e deputetëve të Kuvendit.

Sabri Hamiti, tha se Kuvendi i Kosovës duhet të marrë qëndrim në formë të shkruar lidhur me arrestimin e gjenerallejtënant Agim Çekut. Qëndrimi i Kuvendit duhet të jetë kështu:

Kuvendi kërkon shfuqizimin e të gjitha akteve që i ndërmerrë Serbia ndaj qytetarëve të Kosovës dhe ky shfuqizim në formë të artikuluar me shkrim t'iu dërgohet qeverive evropiane, Interpolit dhe Evropolit.

Kryetari e dha një pauzë prej 30 min. për harmonizimin e qëndrimeve të grupeve parlamentare lidhur me arrestimin e djeshëm të gjenerallejtënant Agim Çekut nga organet e rendit të Sllovenisë.

Pas pauzës, në emër të grupeve parlamentare, deputetja Nekibe Kelmendi e lexoi deklaratën ,si vijon:

Kuvendi i Kosovës, i shqetësuar për arrestimin e komandantit të Trupave Mbrojtëse të Kosovës, gjenerallejtënant Agim Çeku, si dhe për arrestimet e mëparshme të përfaqësuesve të institucioneve të Kosovës, e të qytetarëve të saj, duke kundërshtuar funksionimin e organeve paralele serbe në Kosovë e në Serbi, të emërtuara si gjykata të Kosovës, miraton k ë t ë

D E K L A R A T Ë

1.Kuvendi i Kosovës i konsideron të pavlefshme të gjitha fletëarrestet, vendimet gjyqësore dhe ekzekutimet e këtyre vendimeve që bëhen nga institucionet e Serbisë dhe

nga organet gjyqësore paralele serbe, të cilat funksionojnë në territorin e Kosovës e të Serbisë dhe kanë të bëjnë me qytetarët e Kosovës.

2.Kuvendi kërkon nga institucionet ndërkombëtare në Kosovë dhe jashtë saj, duke përfshirë Interpolin dhe Evropolin, që të mos i njohin këto vendime dhe fletëarreste serbe kundër qytetarëve të Kosovës, sepse Kosova është nën jurisdiksionin e Organizatës së Kombeve të Bashkuara dhe ka institucionet e veta demokratike.

3.Kuvendi kërkon nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm, zoti Hary Hollkeri që të ndërmarrë veprime urgjente për zhbërjen e institucioneve paralele në Kosovë.

4.Kuvendi i Kosovës proteston ndaj veprimit të organeve shtetërore të Sllovenisë lidhur me arrestimin e djeshëm të komandantit të Trupave Mbrojtëse të Kosovës, gjeneral lejtënant Agim Çeku.

Gjatë leximit të deklaratës,deputetët e Koalicionit “Kthimi”,në shenjë proteste e lëshuan seancën.

Kryetari e vuri në votim deklaratën e lexuar dhe rezultati ishte si vijon:

Për-----shumica;
Kundër-----1;
Abstenime-----0.

1. Miratimi i procesverballi të seancës së mëparshme.

Procesverballi i seancës të mëparshme u miratua pa vërejtje.

2. Shqyrtimi i dytë i P/ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë-nr.2003/25.

Kryetari, i informoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve kryesore dhe të Komisionit Funkcional për këtë P/ligj.

Ai vuri në votim amendamentet e Komisionit për Financa dhe Ekonomi, veç e veç.

Kuvendi i miratoi amendamentet 1 dhe 2.

Kryetari e vuri në votim P/ligjin në tërësi dhe rezultati i votimit ishte si vijon:

Për shumica
Kundër0
Abstenime.....2

Kryetari konstatoi se Kuvendi i Kosovës e miratoi Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe të përgjegjësiive.

3. Shqyrtimi i parë i P/ligjit për barazi gjinore-nr.2003/29.

Kryetari e ftoi poropozuesin e P/ligjit ta arsyetonte para deputetëve.

Deputetja Melihate Tërmkollli theksoi se Komisioni për barazi gjinore i Kuvendit të Kosovës ka marrë përgjegjësinë për hartimin dhe përgatitjen e Projektligjit për barazi gjinore me qëllim të rregullimit, mbrojtjes, zhvillimit dhe sanksionimit ligjor të barazisë gjinore si një nga kualitetet fundamentale dhe nga më të rëndësishmet për zhvillimin, ndërtimin dhe demokratizimin e vendit dhe institucioneve demokratike.

Në kohën e ndryshimeve të mëdha që po ndodhin në Kosovë, me ndërtimin e një sistemi të ri politik e juridik të vendit, dimensionin e barazisë gjinore nga të shtruarit krejt sipërfaqësor dhe në rang ndihme, ka marrë karakterin e një çështje serioze të trajtimit institucional, duke ngritur këtë çështje në nivelin e trajtimit ligjor.

Objektivat e këtij Projektligji janë të qarta: normimi, rregullimi dhe sanksionimi i barazisë gjinore në fushën publike të jetës dhe veprimit, si dhe ndërtimi e forcimi i mekanizmave për zbatimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit në të gjitha nivelet e organizimit institucional dhe organizimeve tjera dhe në të gjitha strukturat brenda këtyre niveleve.

Projektligji për barazi gjinore iu referohet dy gjinive dhe nuk është thjesht Projektligj për të drejtat e gruas, ndonëse, në masë të madhe vëhet në funksion të avancimit të pozitës së gruas si gjini më pak e përfshirë në të gjitha sferat e jetës, e me këtë edhe si gjini më pak e faktorizuar në këto sfera dhe në proceset e vendosjes.

Avancimi i pozitës së gruas, sipas këtij Projektligji, ka kuptimin dhe është vetëm në funksion të arritjes së barazisë gjinore dhe në asnjë mënyrë si ndërrim i vendeve apo tendencë dominimi në shoqëri.

Kuota nuk është qëllimi i Projektligjit dhe as qëllimi i barazisë gjinore. Ajo është një mjet për arritjen e barazisë gjinore dhe atë mjet i karakterit tranzicional, që do të pushojë të jetë mjet i tillë kur plotësohen qëllimet e ligjit.

Në këtë Projektligjit janë përfshirë parimet dhe standardet ndërkombëtare, të parapara me aktet dhe konventat ndërkombëtare me të cilat rregullohet fusha e barazisë gjinore dhe e të drejtave të barabarta.

Në fund, ajo i ftoi deputetët e Kuvendit ta miratonin këtë P/ligj.

**Opinionet, vërejtjet dhe sugjerimet në këtë P/ligj i dhanë edhe këta deputetë:
Hatixhe Hoxha, Ramush Haradinaj, Remzije Nimani, Berat Luzha, Mehdi Bardhi,
Fadil Kryeziu, Nekibe Kelmendi, Ismajl Kurteshi, Millovan Jovanoviq dhe Zylfi
Merxha, që i janë bashkangjitur transkriptit.**

Kryesuesi e vuri në votim P/ligjin për barazi gjinore dhe rezultati i votimit ishte si vijon:

Për.....shumica
Kundër..... 1
Abstenime.....0

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi i Kosovës miratoi në parim P/ligjin për barazi gjinore dhe i ngarkoi komisionet kryesore dhe Komisionit për Barazi Gjinore që në afatin prej tri javësh ta shqyrtojnë këtë P/ligj dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime për miratim.

4. Shqyrtimi i parë i P/ligjit për kadastrë-nr.2003/30.

Kryesuesi e ftoi propozuesin e P/ligjit ta arsyetonte para deputetëve të Kuvendit.

Ministri Jakup Krasniq tha se nevoja për nxjerrjen e ligjit për kadastrin është e një rëndësie të jashtëzakonshme për Kosovën, pasi që qytetarëve në marrëdhënie pronëso-rojuriqe, me ligjin e aplikueshëm deri më tani, nuk iu janë ofruar shërbime kadastrale bashkëkohore. Ky ligj do t’i plotësojë zbrastësitë ligjore në këtë fushë. Gjithashtu ky ligj përfshin standardet bashkëkohore në lëmin e kadastrit duke eliminuar ligjet e aplikueshme, të cilat në nivelin e tanishëm të zhvillimit të kadastrit dhe marrëdhënieve pronësore-juridike, janë të pazbatueshme dhe të tejkalaura në Kosovë. Ndryshimet ndërmjet këtij ligji dhe ligjit të aplikuar për kadastrin janë: matja e ngastrave të tokës, e ndërtesave, e pjesëve të ndërtesave si dhe e përçojave. Është fjala për linjat e tensionit të lartë të rrymës, gypat e ujësjellësit, kanalizimit, gypat për transportimin e gasit, të naftës e tjera.

Agjencia Kadastrale e Kosovës do të jetë përgjegjëse për kadastrin dhe procedurat kadastrale, ngase i është ofruar mundësia edhe kompanive private gjeodezike të kryejnë veprimtari kadastrale.

Me këtë P/ligj rregullohen matjet dhe përgatitjet e tjera lidhur me formën e pronës: Është krijuar një sistem më formal për krijimin e pronës, përkatësisht për rregullimin e marrëdhënieve pronësore-juridike; Është formalizuar procedura për përcaktimin e kufijve

kadastralë, procedura e regjistrimit dhe janë qartësuar me përgjegjësi edhe afatet për zyrat komunale kadastrale, por edhe është qartësuar procedura për aplikimin kundër vendimeve të AKK dhe zyrave komunale të kadastrave.

Me këtë P/ligj garantohet trajtimi i barabartë i të gjitha subjekteve që do të merren me punën e kadastrit dhe me matjet kadastrale në Kosovë, siç janë: Agjencia Kadastrale e Kosovës- si autoritet qendror kadastral; zyrat komunale-si organe të nivelit lokal; kompanitë e licencuara gjeodezike; gjeodetë të licencuarë, si dhe kompanitë e tjera.

Me këtë P/ligj përcaktohen kompetencat dhe përgjegjësitë për të gjitha subjektet që do të merren me punën e kadastrit: Agjencia Kadastrale e Kosovës; zyrat komunale të kadastrit; kompanitë e licencuara; gjeodetët e licencuar dhe subjektet e tjera.

Ligji ka një rëndësi të veçantë-përveç veprimtarisë së kadastrit - edhe në themelimin e regjistrimit të të drejtave mbi pronën e paluajtshme dhe regjistrimin e tyre.

Në fund, ministri Krasniqi i ftoi deputetët e Kuvendit ta miratonin këtë P/ligj.

**Opinionet, vërejtjet dhe sugjerimet në këtë P/ligj i dhanë edhe këta deputetë:
Nekibe Kelmendi, Xhelal Canziba, Xhevdet Neziraj, Fatmir Rexhepi dhe Ibush Jonuzi, që i janë bashkangjitur transkriptit.**

Kryesuesi e vuri në votim këtë P/ligj dhe rezultati i votimit ishte si vijon:

Për.....shumica
Kundër.....0
Abstenime.....1.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi i Kosovës e miratoi, në parim, P/ligjin për kadastër dhe i ngarkoi komisionet kryesore dhe Komisionin për Shërbime Publike, që ta shqyrtojnë këtë P/ligj në afatin prej tri javësh dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime për miratim.

5. Propozimi i rendit të ditës për seancën e ardhshme plenare të datës 30 tetor 2003.

Kryesuesi tha se Kryesia e Kuvendit në mbledhjen e mbajtur më 21 tetor 2003 ka vendosur t'ia propozojë Kuvendit rendin e ditës për seancën e ardhshme të datës 30 tetor 2003, si vijon:

1. Shqyrtimi i parë i P/ligjit kundër diskriminimit,
2. Shqyrtimi i dytë i P/ligjit për inspektoratin sanitar dhe
3. Shqyrtimi i dytë i P/ligjit për pensionet e aftësisë së kufizuar.

Ljubomir Stanojković, në emër të Grupit Parlamentar “Kthimi”, propozoi që njëra nga pikat e rendit të ditës për seancën e ardhshme të jetë edhe miratimi i një deklaratë për bashkëpunim me Tribunalin e Hagës.

Kryesuesi tha se Kryesia e Kuvendit do ta shqyrtojë këtë propozim.

Kuvendi e miratoi rendin e ditës të seancës së ardhshme plenare të datës 30 tetor 2003, ashtu si ishte propozuar.

Seanca përfundoi në orën 12:45 minuta.

Sekretaria e Kuvendit

Kryetari i Kuvendit të Kosovës

akademik **Nexhat Daci**